



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

2023/0097

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi - Kryetar duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Eor Group SH.P.K., kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit të KUVENDI KOMUNAL GJILAN në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Rregullimi i dyshemesë të sallës shkollës Zenel Hajdini –Ri-Tender me numër të prokurimit 651-22-7819-5-2-1, me 25/04/2023, mori:

VENDIM

I. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE "Eor Group" SH.P.K. me nr. 2023/0097 , e datës 18/02/2023, kurse vendimi i AK KUVENDI KOMUNAL GJILAN lidhur me aktivitetin e prokurimit Rregullimi i dyshemesë të sallës shkollës Zenel Hajdini –Ri-Tender me numër të prokurimit 651-22-7819-5-2-1 ANULOHET, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.

II.URDHËROHETAutoriteti Kontraktues- Komuna Gjilan,që në afat prej 5 (pesë) ditësh kalendarike të njoftoj OSHP-në dhe operatorin ekonomik OE "Eor Group" SH.P.K lidhur me zbatimin e vendimit të OSHP-së: PSh. nr. 592/22, datë 22.12.2022,si dhe venidmin e OSHP-së PSh. 0097/2023 lidhur me pretendimet e gjykuara për aktivitetin e prokurimit me titull Rregullimi i dyshemesë të sallës shkollës Zenel Hajdini –Ri-Tender me numër të prokurimit 651-22-7819-5-2-1

III. Mos respektimi i kësaj urdhërese në afat prej pesë ditësh kalendarike do ta detyrojë Panelin Shqyrtues që të veproj konform nenit 131 të LPP-së dhe në të njëjtën kohë të kërkojë nga KRPP-ja, anulimin e licencës për menaxherin e prokurimit të AK-së /Komuna e Rahovecit, konform nenit 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së.

IV. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik Eor Group SH.P.K.

ARSYETIM

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me datën 03.02.2023, KK Gjilan në cilësinë e AK ka publikuar Njoftimin për dhënie të kontratës të aktivitetit të prokurimit me titull: “Rregullimi i dyshemesë të sallës shkollës Zenel Hajdini –Ri-Tender” me nr. të prokurimit: "651-22-7819-5-2-1"

OE “Eor Group” Sh.P.K. & “Beni Company” Sh.P.K. më 07.02.2023 dërgon kërkesën për ri-shqyrtim, ndërsa AK më 10.02.2023 merr vendim për **anulimin e tenderit**.

Me datën: 18.02.2023, OE “Eor Group” Sh.P.K. & “Beni Company” Sh.P.K. - Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0097, kundër vendimit për anulimin e tenderit të datës 10.02.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Rregullimi i dyshemesë të sallës të shkollës Zenel Hajdini –Ri-Tender” me nr. të prokurimit: "651-22-7819-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Kuvendi Komunal Gjilan.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 23,000.00 €, ekzekutimi i kontratës: thirrje/porosi, përderisa kriter i dhënies ka qenë çmimi më i ulët.

Lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP- së, me nr. 592/22 i dt: 22.12.2022.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkritazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 03/03/2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa e OE ankues të aprovohet, si e bazuar.

- të anulohet vendimi i AK-së ndërkaq aktiviteti i prokurimit me të dhënat sipër shënuar të kthehet në **rivlerësim**.

Në pretendimin nr. 1 (LPP/Neni 1) Autoriteti Kontraktues - KK Gjilan, nuk e ka përdorur mënyrën më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, rezultat i cili vërehet në njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, prandaj ky pretendim qëndron duke e marrë parasysh se kontrata i është dhënë OE N.N.T. Engineering VITI, ku pas vlerësimit për dhënie të kontratës në mënyrë joefikase, AK e ka rekomanduar kompaninë fituese duke vepruar në kundërshtim me vendimin e OSHP-së nr. 592/22, nenin 1 të LPP-së si dhe duke mos e respektuar kriterin e çmimit më të ulët.

Eksperti shqyrtues lidhur me pretendimin nr. 2 (LPP/Neni 6) të OE ankues se AK pas vlerësimit për dhënie të kontratës nuk ka vepruar sipas nenit 6 të LPP-së pasi që OE EOR GROUP SH.P.K. & BENI COMPANY SH.P.K. është OE me ofertën më të lirë, qëndron për faktin se AK është dashur të pranoj si të mirëqenë

vendimin e OSHP-së nr. 592/22, për të arritur rezultatin e duhur.

Eksperti shqyrtues lidhur me pretendimin nr. 3 (LPP/Neni 7) të OE ankues se AK ka bërë shkelje të këtij neni, gjithashtu qëndron sepse kontratat e prezantuara nga Grupi i OE EOR GROUP SH.P.K. & BENI COMPANY SH.P.K. janë plotësisht në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit, përderisa OE N.N.T. Engineering VITI nuk ka dëshmuar asnjë punë të ngjashme të dyshemeve, pasi me këto referenca AK nuk ka mundësi të vërtetojë se OE N.N.T. Engineering VITI ka kontrata të ngjashme (dysheme) në vlerën e kërkuar 30,000 € me dosjen e tenderit. OE N.N.T. Engineering VITI gjithashtu nuk ka vazhduar validitetin e ofertës dhe nuk ka plotësuar kërkesat e dhëna me dosjen e tenderit dhe ka çmim më të lartë se Grupi i OE EOR GROUP SH.P.K. & BENI COMPANY SH.P.K., pra është diskriminuar nga AK dhe nuk është trajtuar konform vendimit nr. 592/22 të OSHP-së dhe LPP-së.

Eksperti shqyrtues lidhur me pretendimin nr. 4 (LPP/Neni 59) të OE ankues se AK pas themelimit të Komisionit Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave, nuk e ka vlerësuar ofertën në bazë të kërkesave të dosjes, sqaron se ky pretendim qëndron sepse në këtë rast për shkak të mos vlerësimit real dhe profesional ka zgjedhur kompaninë N.N.T. Engineering VITI. Grupi i OE EOR GROUP SH.P.K. & BENI COMPANY SH.P.K. i plotëson të gjitha kërkesat e dhëna me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit si dhe është OE e përgjegjshme, në pajtueshmëri me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale dhe me çmimin më të lirë të ofruar, përderisa OE N.N.T. Engineering VITI nuk ka prezantuar dëshmi, që e argumenton se punëtori i certifikuar ka marrëveshje që do të angazhohet për kryerjen e punëve siç është kërkuar me DT, neni 9.1 & 9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale: (Si dëshmi kërkohet që për këtë punëtor të ketë së paku një (1) referencë për montimin e dyshemesë.)

Eksperti shqyrtues lidhur me pretendimin nr. 5 (LPP/Neni 60) të OE ankues se AK nuk i ka respektuar kriteret e dhënies së kontratës përderisa kriter i dhënies ka qenë çmimi më i ulët, me ç'rast AK nuk e ka respektuar kriterin e dhënë duke u mbështetur në dokumente jo të duhura, dhe se OE ka të drejtë në këtë pretendim sepse e ka ofertën më të lirë. Ky kriter nuk është respektuar dhe se OE ankues është në pajtueshmëri me të gjitha kriteret e kërkuara në dosje.

Faktet tjera mbështetëse:

Fillimisht me vendimin e datës 07.09.2022 për kontratë rekomandohet fitues OE EOR GROUP SH.P.K. & BENI COMPANY SH.P.K., mirëpo pas kërkesave për rishqyrtim kundër këtij vendimi, AK e kthen në rivlerësim këtë aktivitet me arsyetimin se pretendimet ankimore janë të bazuara, ku e rekomandon OE tjetër me çmim më të lartë. Me vendimin e datës 12.10.2022 AK eliminon OE ankues me arsyet se këtij grupi të OE në DT dhe në Njoftimin për kontratë i është kërkuar që të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në 3 vitet e fundit në një vlerë jo më pak se 30,000 €, si dhe dëshmia 1. një listë të kontratave të realizuara, në pajtim me Aneksin 7 të DT, duke e saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit, datën e përfundimit të kontratës dhe përfituesin, si dhe listës t'i bashkëngjiten referencat dhe pranimit teknik ose certifikatat për kryerjen e punëve, përderisa në ofertën e tyre këto dëshmi nuk figurojnë, prandaj kjo ofertë konsiderohet e papërgjegjshme.

Më 07.02.2023 në kërkesën për rishqyrtim është paraqitur lista e kontratave të OE EOR GROUP SH.P.K. & BENI COMPANY SH.P.K. të punëve të realizuara të dyshemeve apo të natyrës së ngjashme dhe me vlerë të punëve të ngjashme të kryera më shumë se 30,000 sipas kërkesës së dhënë me dosjen e tenderit:

Duhet theksuar se ky Aneks është obligativ që të plotësohet dhe t'i bashkëngjiten certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër që evidenton performimin e tillë. Prandaj, OE ankues është e përgjegjshme, në pajtueshmëri me Aneksin 7 dhe me çmimin më të lirë të ofruar.

Gjithashtu OE EOR GROUP sh.p.k. & BENI COMPANY sh.p.k. ka vazhduar validitetin e ofertës pa shkëputje dhe e ka dërguar te Autoriteti Kontraktues dhe njëherit e ka ofertën më të lirë. OE Group e ka vazhduar vlefshmërinë e validitetit më 11.11.2022, më 09.12.2022 dhe së fundi më 11.02.2023, përderisa OE N.N.T. Engineering VITI nuk e ka vazhduar validitetin e ofertës siç parashihet me LPP.

Sipas nenit 31.4 të RrUOPP, parashihet se: Nën situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve për arsye të detajeve komplekse teknike të sqaruara, AK do të kërkoj nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. Kërkesa për zgjatje të validitetit të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohet para datës së skadimit [...]; 31.5 Në përputhje me rrethanat, nga të gjithë tenderët do të kërkohet që gjithashtu të zgjasin validitetin e sigurimit të tenderit të tyre; 31.6 Është e hapur për secilin OE të vendosë nëse dëshiron të përtërijë validitetin e tenderit apo jo. OE të cilët vendosin të mos zgjasin validitetin e tenderëve të tyre do të refuzohet si “të papërgjegjshëm” dhe kështu AK nuk do të konfiskoj sigurimin e Tenderit të tyre. Kështu pra, bazuar në nenin 31 të RrUOPP ky OE është i papërgjegjshëm dhe nuk mund të shpallet fitues, pasi nuk plotëson kërkesat e dhëna me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit.

Autoriteti Kontraktues me vendimin e datës 10.02.2023 është në kundërshtim me nenin 44 të RrUOPP dhe me dispozitat e tjera të lartëcekura të LPP-së, sepse sipas nenit 44.6 Procedura e prokurimit pas marrjes së ofertave mund të anulohet vetëm për arsyen e mëposhtme: (i) të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK, e jo për arsye tjera.

Gjithashtu sipas vendimit të OSHP-së nr. 592/22 të datës 22.12.2022, arsyet e eliminimit janë hedhur poshtë dhe AK nuk e ka bërë rivlerësimin e ofertave në përputhje me kriteret e përcaktuara kualifikuese dhe kriterin e përcaktuar për vlerësim, sepse në dëshmitë dokumentare janë të bashkëngjitura referencat me kontrata të ngjashme siç janë kërkuar në dosjen e tenderit dhe se OE i cili merret me punët e ndërtimitarisë, sipas këtyre kriterëve, është në gjendje që të kryej punët e dyshemesë.

Duhet theksuar se parimet kryesore të procedurës së vlerësimit, sipas LPP, ndër të tjera janë që:

[...] Tenderët e përgjegjshëm do të vlerësohen në bazë të kriterëve të specifikuar të dhënies së kontratës dhe se vetëm kërkesat dhe kriteret e dhënies së kontratës të specifikuar në njoftim për kontratë/dosje të tenderit mund të përdoren si bazë për vlerësim.

Në DT theksohet se ai OE që nuk është në pajtim me të gjitha kërkesat e paraqitura në dosjen e tenderit, do të refuzohet dhe do të konsiderohet si “tender i papërgjegjshëm”.

Përfundimisht, në pajtim me nenin 59 të LPP-së, paragrafin 4 parashihet se: Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm pasi tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, e që në këtë rast OE është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklaramit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij paneli.

Paneli shqyrtues konstaton se AK obligohet që konfrom mendimit të ekspertit lëndën ta kthej në rivlerësim me qëllim të trajtimit të barabartë të OE-ve.

Paneli Shqyrtues kërkon nga AK që të njëjtit të jenë të vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik në të ardhmen duke respektuar në përpikmëri Ligjin e Prokurimit Publik dhe rregullat e zbatueshme, dhe po ashtu urdhëron të njëjtit të veprojnë në harmoni me rekomandimet e dhëna në këtë vendim, në të kundërtën Organi Shqyrtues i Prokurimit nga kuadri i Paneleve Shqyrtuese, ka të drejtë të kërkoj ndërmarrjen e masave disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK - **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**

1x1 OE - **Eor Group SH.P.K.**

1 x 1 Arkivës së OSHP-së:

1 x 1 Për publikim në ueb-faqe të OSHP-së

